

P7



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

NR.REGJ. 1380/329
DATA E REGJISTRIMIT 21.12.2023

NR. 5934/9 VENDIMI
DATA 04.04.2024

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË, E PERBERE NGA:

Sot me date 04.04.2024, perfundova ne shqyrtim në dhomë këshillimi kerkesen qe i perket:


KERUESI: Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), përfaqësuar nga Presidenti z. Fidel YLLI, dtl. 01.09.1962, i lindur në Tiranë, banues në Tiranë, Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik, Tiranë.

OBJEKTI: Depozitimi dhe regjistrimi i Vendimit dt. 02.12.2023 të Asamblesë së Përgjithshme Vjetore te 29-të të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH).

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Shqipërisë; Ligji Nr. 8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", i ndryshuar; Ligjit Nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", LIGJI Nr. 79/2017 Për SPORTIN.

VEREN:

Kerkuesi, ka paraqitur ne gjykate kerkesen per regjistrimin e vendimarrjes se asamblese se Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, të datës 02.12.2024. Komiteti Olimpik Kombëtar është person juridik, i krijuar në formën e shoqatës me anëtarësi, e regjistruar në Regjistrin e OJF-ve me vendim Nr. 5934, datë 22.6.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka qellim promovojë dhe të mbrojë Lëvizjen Olimpikë në Shqipëri në përputhje me Kartën Olimpikë. KOKSH vepron në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, Ligji Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për



Handwritten signature: Beselulsky

Organizatave Jofitimprurëse", Kartën Olimpikë. Ligji Nr. 79/2017 Për Sportin si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë fushë të veprimtarisë së saj. KOKSH në Asambleenë e Përgjithshme Vjetore Nr.29 të datës 02.12.2023, ka patur rendin ditës si vijon:

Shqyrtimi i Anetaresisë i Federates Shqiptare (bazuar në Nenin 13 dhe 14 të statutit të KOKSH), për përjashtimin e: a. Federata Shqiptare Sportit për të Gjithë; b. Federata Shqiptare e Aeronautikës; c. Federata Shqiptare e Automobilistëve; d. Federata Shqiptare e Badmintonit. - votimi për Anetarin themelues të KAS Znj, Aida (Gugu) Bushati. - Miratimi i ndryshimeve në Statut. - Miratimi i Projektit "Ekipet Sportive në Shkollë" dhe buxhetit të Projektit. - Shqyrtimi i ndryshimit të kuotizacionit. - Miratimi dhe ratifikimi i vendimeve të marra nga KOKSH në Asambleenë e Përgjithshme date 29 Tetor 2022 dhe Asambleenë e Përgjithshme 29 Prill 2023. - Miratimi i Raportit Auditues për 2022. -Miratimi i ndarjes së Cmimeve "Urdher Olimpik" të Asamblese së KOKSH, date 29 Prill 2023. -Ndarja e Cmimeve "Urdher Olimpik".

Gjykata vëren se vendimarrje e regjistrueshme është vetëm ajo në lidhje me anëtarësinë si dhe me votimin e anëtarit themelues të KAS Aida (Gugu) Bushati, ndryshimeve statutore, miratimin e vendimeve të marra nga Asambleja e Përgjithshme e KOKSH në mbledhjen e datës 29 Tetor 2022 dhe 29 Prill 2023.

Pasi u administruan fashikujt e regjistrimeve të mëparshme, vërehet se formalisht kërkesa është e rregullt dhe duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar në Kodin Civil, ligji Nr.8788, date 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", ligji Nr.8789, date 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Depozitimin në regjistrat e OJF-ve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës, të vendimarrjeve të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, të datës 02.12.2024.
 3. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës kerkuese.
- U shpall në Tiranë, me datë 04.04. 2024

GJYQTARE
Alma KODRALIU

